



**Titulli i projektit**

Përmirësimi i Gjellbërimit të Qytetit të Kukësit

**Tipi i projektit**

Përmirësim infrastrukture

**Vendndodhja e projektit**

Kukës

**Buxheti i paravlerësuar**

50,000 euro

**Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve**

Qyteti i Kukësit është një qytet, ku duket ndjeshëm mungesa e ambienteve të gjelbërta dhe zonave të sistemuara e të gjelbëruara. Me nismën e Institucionit të Prefektit të Kukësit është përgatitur projekti për rehabilitimin e sheshit kryesor të qytetit të Kukësit "Skënderbej", projekt që parashikon të rehabilitojë dhe funksionalizojë një nga sheshet kryesore të qytetit. Megjithatë nevojitet të kryhen ndërhyrje dhe në zonat midis lagjeve të qytetit për të rritur sipërfaqen e hapësirave të gjelbërta.

Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Kukës, në zbatim të programit të punës për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe drurëve dekorativë në qytet, është në proces të mbjelljes së drurëve dekorativë të llojit "bli" në rrugët e Lagjes së Re. Deri në përfundim të programit mbeten për t'u mbjellë dhe 95 rrënjë bli. Por me qëllim zgjerimin e zonave të gjelbërta dhe përmirësimin të cilësisë së ajrit dhe pamjes së qytetit, nevojitet shtimi i zonave të gjelbëruara në lagje të tjera.

**Qëllimi/et specifik të projektit**

OS1: Të zgjerohen zonat e gjelbëruara të qytetit.  
OS2: Të krijohen ambiente më të pastra dhe çlodhëse

**Rezultatet e pritshme dhe treguesit**

R1: Gjellbërim i shtuar në sheshin "Skënderbej"  
R2: Zona të gjelbërta të shtuara në lagjet e qytetit

# PROJEKTI 11



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

1. Ngritja e grupit të punës për identifikimin e të gjitha zonave ku mund të ndërhyhet
2. Përgatitja e projekteve për gjelbërimin e zonave të përzgjedhura
3. Blerja dhe mbjellja e pemëve
4. Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta në zonat e përzgjedhura

## Maturimi i projektit

Ekziston një projekt-ide për projektin.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financuesit e projektit:  
Nuk ka ende fonde të siguruar nga donatorët.

Projekti do të zbatohet nga:  
- Bashkia Kukës

## Kostot e projektit

Kostoja e projektit është afërsisht 50,000 Euro.